



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 55  
Prishtinë, më 11.2.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Driton Çausi, Abdyl Salihu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Arbërie Nagavci dhe Luljeta Veselaj - Gutaj.

**Munguan:** Mufera Shinik, Albulena Balaj-Halimaj, Fidan Rekaliu, dhe Verica Çeraniç.

**Përfaqësues të tjerë:** Laborantët e FSHMN-, përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25.1.2019 dhe 4.2.2019;**
- 3. Takim i komisionit me laborantët e FSHMN-së, Departamenti i Kimisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25.1.2019 dhe 4.2.2019.**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura nuk u shqyrtuan, mbetet të votohen në mbledhjen e ardhshme.

## **3. Takim i Komisionit me laborantët e FSHMN-së, Departamenti i Kimisë**

Ismajl Kurteshi tha se takimi me laborantët e punësuar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universiteteve Publike është bërë me kërkesën e laborantëve me qëllim të njohjes së përafërt me kërkesat e tyre që kanë të bëjnë me çështjen e statusit të tyre, si dhe propozimin për amendamentimin e Projektligjit nr.06/L-135 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Në vazhdim fjala iu dha laborantëve.

Ara Rudi në diskutimin e saj tha se laborantët e Universitetit Publik janë të diskriminuar për faktin se trajtimi i tyre si staf administrativ nuk përkon me punën që e bëjnë, andaj kërkojnë rregullimin e statutit të tyre si staf ndihmës akademik në procesin mësimor.

Bazuar në detyrat, përgjegjësitë dhe ndërlikueshmërinë e punës aktiviteti ditor i laborantëve përcillet me pjesëmarrjen dhe organizimin në procesin mësimor të Fakultetit të Shkencave Matematike- Natyrore në laboratorët e Fakultetit të Kimisë dhe se kategoria e tyre është e ngarkuar me 40 orë mësim në laborator, e cila është e pamundur për t'u rezistuar. Ajo shtoi se përgjegjësinë dhe performancën e laborantëve e bënë sekretari i universitetit, i cili nuk ka të bëjë me punën që kryhet në laboratorë brenda ditës.

Laborantët e tjerë të Universiteteve Publike gjithashtu shprehën kërkesat e tyre lidhur me pozitën dhe statusin e tyre të punës. Ata deklaruan se puna e tyre është e lidhur ngushtë me procesin mësimor që nga orari i punës ku përcaktohet nga orari mësimor (dhe jo orari i administratës siç është nga ora 8:00-16:00) pjesëmarrja në ushtrimet laboratorike me studentë dhe në laboratorë hulumtuese, përgatitja e ushtrimeve laboratorike sipas syllabusëve të lëndëve përkatëse të përcaktuara nga stafi akademik e kështu me radhë.

Bazuar në këto kërkojnë që në ligjin për arsimin e lartë të përfshihen të gjitha kategoritë e të punësuarve në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe me këtë statuti i laborantëve si staf ndihmës akademik dhe të rregullohet me ligj në mënyrë që kategorizimi i laborantëve nga stafi administrativ të shndërrohet në staf ndihmës akademik në procesin mësimor.

Driton Çausi tha se jemi këtu për të shqyrtuar mundësinë e krijimit të një statusi për laborantët dhe gjetjen e një zgjidhje sa më të mirë, sa i përket pozicionit të tyre. Lidhur me këtë ai tha se do të bëjmë përpjekje t'i marrim praktikat më të mira nga vendet e rajonit dhe me këtë rast ideja më e mirë është që me rastin e shqyrtimit të Ligjit për Arsimin e Lartë të gjendet një formë për pozicionin e laborantëve.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj, tha se çështja e laborantëve është një çështje me të cilën jemi njoftuar edhe më herët dhe se do të shqyrtohet mundësia e trajtimit të kësaj çështje me Projektligjin për Arsimin e Lartë i cili pritet të miratohet në lexim të parë në Kuvend.

Ajo kërkoi sqarim lidhur me adresimin e kërkesave të tyre drejtuar Dekanatit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit, si dhe në ndërmarrjen e masave me rastin e përfshirjes së tyre me Ligjin për Paga, ndërsa i siguroi se do të mbështes zgjidhjen e kërkesës së laborantëve.

Valentina Bunjaku- Rexhepi shprehi gatishmërinë dhe përkrahjen ndaj laborantëve, për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të mirë, e cila do e rregullonte vendin dhe pozicionin e tyre të punës. Ajo tha se në këtë aspekt edhe ndryshimi i Statusit të Universitetit mund të ndikonte në ndryshimin e statusit të laborantëve.

Arbërie Nagavci, në diskutimin e saj, tha se si komision u njoftuam me specifikat e punës së laborantëve dhe shprehi gatishmërinë e saj për zgjedhjen e qëndrueshme të statusit të laborantëve dhe trajtimin e duhur edhe përmes shqyrtimit të Projektligjit për Arsimin e Lartë, i cili është në procedurë në Kuvend. Ajo kërkoi nga laborantët që propozimet konkrete t'i procedojnë në komision në mënyrë që të njëjtat të shqyrtohen gjatë fazës së shqyrtimit të Projektligjit.

Luljetë Veseli - Gutaj tha se mbështetja e komisionit krahas kërkesave të laborantëve nuk do të mungojë dhe në këtë aspekt do të mundohemi të gjejmë një formë dhe një zgjidhje për këtë kategori, sipas praktikave të vendeve të rajonit me qëllim të rregullimit të pozitës së tyre.

Në vazhdim kërkoi sqarim se a mund të rregullohet statusi i laborantëve edhe me ligjin për Zyrtarët Publik.

Ismajl Kurteshi tha se komisioni përkrahë idenë në gjetjen e një zgjidhjeje sa më të mirë sa i përket pozitës së laborantëve dhe në këtë aspekt tha se brenda një afati të shkurtë komisioni do të takohet me ministrin e Arsimit dhe Rektorin e Universitetit të Prishtinës, me qëllim të shqyrtimit të këtyre kërkesave. Ai tha se sensibilizimi i kësaj çështjeje ndikon në zgjedhjen më të shpejtë të kësaj kategorie për të cilën janë pajtuar edhe Dekanati dhe Këshilli Drejtues, andaj komisioni do të angazhohet që sa më parë të gjejë një zgjidhje për këtë kategori.

#### **4. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**